



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

**Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Dega e Artit Dramatik – Moduli: Kostmografi**

**Me datë: 27.03.2024**

<b>Nr.</b>	<b>Kandidati</b>	<b>Titulli i temës</b>	<b>Komisioni</b>
1.	Diana Drançolli	Një thurje në kohë	Prof. Zeni Ballazhi - Kryetar Prof. Agnesa Muharremi Kastrati - Mentor Prof. Burim Arifi - Anëtar

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS – “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I ARTEVE**

**DEPARTAMENTI I ARTEVE DRAMATIKE**

**MODULI: KOSTUMOGRAFI**



Koncept-propozim për punim të temës së Masterit

**“NJË THURJE NË KOHË”**

Mentori: Prof. Agnesa Muharremi KASTRATI  
Kandidatja: Diana DRANÇOLLI

PRISHTINË, 2024

## **SHQIP**

Kostumografia konsiderohet si një fushë mjaft e rëndësishme në analizimin e ornamentikës tradicionale sepse përdoret si mjet për të ruajtur trashëgiminë kulturore dhe për të stimuluar identitetin kulturor, përmes dizajneve që një kostumograf mund të krijoj dhe ti shfaq në interpretime të ndryshme qoftë teatrale ose komerciale. Në përgjithësi në Kosovë nuk është që kemi edhe shumë analiza të kostumeve në këtë lloj forme, e sidomos të mirren si shembuj që të ndryshohen këto veshje në kontekst artistik/modern. Objektivi kryesor i këtij hulumtimi është të demonstrojë lidhjen e fortë ndërmjet veshjeve tradicionale të rajonit të Hasit dhe procesin tim krijues të kostumeve bashkëkohore të inspiruara nga këto veshje. Detajet dhe rikrijimi i veshjeve në një kontekst modern të përfshirë në këtë proces mund të shihen si një formë e shprehjes artistike, duke ruajtur traditat kulturore dhe duke krijuar lëvizje inovative.

Me analizimin e kuptimeve që shprehin detajet, mundohem të nxjerr në pah rëndësinë kulturore, sociale dhe historike, për më tepër, thekson inspirimin tim individual të tyre në dizajnin bashkëkohor të kostumeve. Nëpërmjet këtij hulumtimi, dëshmohet se si veshjet tradicionale të Hasit shërbejnë si një relacion që lidh të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, duke shpresuar që kjo punë të ndihmoj në promovimin dhe ruajtjen e vlerave të kulturës kosovare dhe të mund të konsiderohet përdorimi i tyre që të sjellë një pasuri të re dhe një ndërveprim pozitiv midis trashëgimisë kulturore dhe kreativitetit bashkëkohor në botën e modës.

Fjalët kyçe: Kostumografia, veshje tradicionale, Kosovë, veshja e Hasit, ruajtja kulturore, trashëgimia, inovacioni, riinterpretimi modern, shprehja e identitetit.

## **ANGLISHT**

Costume design is considered a very important field in the analysis of traditional ornamentation because it is used as a tool to preserve cultural heritage and to stimulate cultural identity, through designs that a costume designer can create and display in different interpretations, whether theatrical or commercial. In general, in Kosovo, we don't have many analyzes of costumes in this type of form, especially if they are taken as examples to change these clothes in an artistic/modern context. The main objective of this research is to demonstrate the strong connection between the traditional clothing of the Hasi region and my creative process of contemporary costumes inspired by these clothing. The detailing and re-creation of clothing in a modern context involved in this process can be seen as a form of artistic expression, preserving cultural traditions and creating innovative movements.

By analyzing the meanings expressed by the details, I try to highlight the cultural, social and historical significance, moreover, it emphasizes my individual inspiration of them in contemporary costume design. Through this research, it is proven how the traditional clothes of Hasi serve as a relationship that connects the past, present and future, hoping that this work will help to promote and preserve the values of Kosovar culture and that their use can be considered to bring a new richness and a positive interaction between cultural heritage and contemporary creativity in the world of fashion.

Key words: Costume design, traditional clothing, Kosovo, Has costumes, cultural preservation, heritage, innovation, modern reinterpretation, expression of identity.